



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:963/25 Datë: 31.07.2025

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ. nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë), nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 (GZ. nr. 14 / 9 shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr. 05/L-031 (GZ. nr. 20 / 12 qershor 2016), Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullores (AKA) nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në nivelin Bachelor dhe Master, Rregullores (AKA) nr. 02/2025 për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 141-të, të mbajtur më 21.08.2025, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet programi i studimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Biznes dhe Ekonomi, PhD, 180 ECTS (A); me kuotë 9 studente për vit akademik.*
- II. Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, të raportojë dhe arsyetojë në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

1/2

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Biznes dhe Ekonomi, PhD, 180 ECTS (A);</i>	Fisnik Morina Vlora Berisha Dranqolli Gani Asllani Bedri Statovci Vehbi Ramaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; *Biznes dhe Ekonomi, PhD, 180 ECTS (A);* vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit është organizuar me datë 13.06.2025. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit ka konstatuar se ky program është vlerësuar se i përmbush të gjitha fushat e standardeve themelore 36/36 dhe 14 nga 16 fushat e standardeve suplementare të përcaktuara me Manualin e standardeve të doktoratës.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 139-të, të mbajtur më datë 30.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë